



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 125/2013 “PËR KONCESIONET DHE
PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, TË NDRYSHUAR**

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 81, pika 1 të saj, në cilësinë e subjektit kushtetues për të ndërmarrë nismë legislative, ne një grup deputetësh propozojmë këtë projektligj. Arsyet e ndërmarrjes së kësaj nisme ligjore janë të shprehura në këtë relacion që shoqëron projektligjin.

1. Qëllimi i projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen:

Qëllimi i këtij projektakti (në nenet 1,2 dhe 3) është përfshirja e Konceptit të **“Vlerësimit të Alternativës”** në aktin bazë (pra në ligj) që rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private, për investime të bazuara në koncesione/partneritete publike, si dhe përfshirja e aktorëve të tjerë në dhënien e këtij vlerësimi.

Gjithashtu, qëllimi i këtij projektakti (neni 4) është parashikimi i përfshirjes së Kuvendit të Shqipërisë në dhënien e miratimit për procedurat koncesionare me kohëzgjatje mbi 4 vjet.

Më poshtë po paraqesim një analizë të këtyre shtesave:

- 1) Në lidhje me ndryshimet e propozuara në nenet 1,2 dhe 3 të këtij projekt ligji, sqarojmë se në Ligjin nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat nuk parashikohet koncepti “Vlerësimit të Alternativës”.

Ndërkohë në VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat” konkretisht në nenet 4 (pika 3), 8 (pika 1) dhe 9 (pika 1, gërma “ç”) parashikohet se studimi i fizibilitetit duhet të përcaktojë dhe vlerësojë se: *alternativa përmes së cilës është parashikuar të përfundojë projekti nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncesion/PPP është më e dobishme në krahasim me alternativën e dhënies së një kontrate prokurimi public*, por të gjitha këto përcaktime i atribuohen vetëm Komisionit të Dhënies me Koncesion. Aktualisht, në nenin 18 të Ligjit 125/2013 përcaktohet se:

- 1. Për shqyrtimin dhe dhënien e koncesionit /partneritetit publik privat, autoriteti kontraktues, në koordinim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private, krijon komisionin e koncesionit/partneritetit publik privat.*
- 2. Anëtarët e komisionit duhet të jenë me profesion jurist, ekonomist, profesion teknik dhe profesione nga fusha të tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të koncesionit /partneritetit publik privat.*
- 3. Numri i anëtarëve në komisionin e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është tek, por jo më pak se 5 anëtarë, nga të cilët jo më pak se 2 janë nga Njësia e Trajtimit të Koncesioneve /Partneriteteve Publike Private. Për projekte koncesioni/partneriteti publik privat, objekti i të cilave është i ngjashëm në natyrë, mund të krijohet një komision i vetëm.*

Shtesa që propozohet ka të bëjë pikë së pari me përfshirjen në aktin më të Lartë pra në Ligj të këtij koncepti, si dhe me përfshirjen e aktorëve të tjerë në dhënien e “vlerësimit të alternativës” konkretisht Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Avokatura e Shtetit.

Arsyeja se pse kërkohet të përfshihen këta aktorë të tjerë ka të bëjë me faktin se:

Kontratat e koncesioneve/partneriteteve publike private në thelb japin të drejta afatgjatë për punë apo shërbime të Shtetit Shqiptar, kompanive private.

Përpara se të vazhdohet me procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat, është shumë e domosdoshme vlerësimi i projektit dhe mundësia nëse ky projekt mund të realizohet me një procedurë prokurimi standard.

Ministria e Ekonomisë, referuar VKM nr. 575 deri diku është e përfshirë në këtë vendimmarrje nëpërmjet ATRAKO-s, ndërsa përfshirja e Ministrisë së Financave gjykojmë se është e domosdoshme në dhënien e vlerësimit, pasi ky Institucion është përgjegjës për planifikimin e financave të shtetit e rrjedhimisht mendimi i këtij Institucioni në momentin e vlerësimit të studimit të fizibilitetit për dhënien e “vlerësimit të alternativës” do të ishte bazik në përcaktimin e fizibilitetit nga ana financiare, të një projekti koncesionar, në raport me një kontratë prokurimi.

Po kështu, përfshirja e Avokaturës së Shtetit në këtë fazë, do të ndihmojë procesin e “vlerësimit të alternativës” me një asistencë ligjore të vyer.

- 2) Në lidhje me ndryshimin e propozuar në nenin 4 të këtij projekt ligji, sqarojmë se në Ligjin nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, në nenin 26 Lidhja e kontratës, pika 5 parashikohet se:

“Kontrata hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga personi i autorizuar i autoritetit kontraktues dhe ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi”.

Po kështu në nenin 30 Afati i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, pika 3 parashikohet se:

“Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se 35 vjet”.

Siç e theksuam më sipër, kontratat e konçesioneve/partneriteteve publike private, në thelb u japin të drejta afatgjatë për punë apo shërbime të Shtetit Shqiptar, kompanive private.

Parashikimi që kontratat koncesionare me afat mbi 4 vjet, të hyjnë në fuqi, pasi miratimit të tyre nga Kuvendi i Shqipërisë është e motivuar nga arsye parimore pasi:

1. Afatet me te gjata se sa 4 vjete per kontratat koncesionare, jane afate zbatimi qe kalojne mandatet politike te maxhorancave dhe si te tilla imponojne nje pergjegjesi politike shteterore afatgjate dhe detyrimin e zbatimit te tyre korrekt nder vite pavaresisht cdo lloj ndryshimi te karakterit politik.
2. Duke qenë se kontratat e konçesioneve/partneriteteve publike private, në thelb u japin të drejta afatgjatë për punë apo shërbime të Shtetit Shqiptar kompanive private, miratimi i këtyre kontratave koncesionare nga Kuvendi i Shqipërisë siguron maksimizimin e garancive ligjore dhe financiare per investitorët privatë në lidhje me projektet afatgjata ku ata kanë investuar, e rrjedhimisht shërben si bazë për thithjen e investimeve të tjera të mundshme, pasi investimet e tyre do të jenë me të sigurta.